



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar / Prilapen me Data 01-07-2026			
Nr. Dokument Org. Breg	Numri Breg	Shifra e Provoj	Vlera Vrednost
12-	035/62-	660	



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Komisioni për ankesa në përbërje, Avdirrahman Sadiku (kryesues i komisionit), Arian Alidema(anëtar),Bashkim Sadiku (anëtar), në mbledhjen e mbajtur me datën 01.07.2026, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës, si: ankesën e OJQ Shoqeria Kulturore-Artistike “SHKA-Jonuz Ramadani” me Nr. 12-320/04-18934 e datës 23.06.2026, kundër Vendimit të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-310/02-620, të datës 22.06.2026, në përputhje me neni 9 dhe 21 të Rregullores MF – Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, komisioni merr këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet si e pabazuar** ankesa e OJQ Shoqeria Kulturore-Artistike “SHKA-Jonuz Ramadani” me Nr. 12-320/04-18934 e datës 23.06.2026, e përfaqësuar nga z.Muhamet Maliqi nga fsh.Smirë, kundër Vendimi të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-310/02-620, të datës 22.06.2026.
2. **Mbetet në fuqi** Vendimit i listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-310/02-620, të datës 22.06.2026.

Arsyetim

Komisioni për ankesa, në mbledhjen e mbajtur me datën 01.07.2026 shqyrtoj ankesën e OJQ Shoqeria Kulturore-Artistike “SHKA-Jonuz Ramadani” e përfaqësuar nga Z.Muhamet Maliqi me Nr. 12-320/04-18934 e datës 23.06.2026, kundër Vendimit të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-310/02-620, të datës 22.06.2026., të publikuar nga komisioni prej 5 anëtarëve, me pretendime për paknaqësinë me përkrahjen që i është bërë në lidhje me shumën financiare të miratuar nga komisioni vlerësues.

Komisioni i ankesave, bazuar në vlerësimet e hollësishme të çdo prove veç e veç dhe çdo prove së bashku, si dhe bazuar në rezultatet e tërësishme të shqyrtimit administrativ, konstaton se, ankesa e OJQ Shoqeria Kulturore-Artistike “SHKA-Jonuz Ramadani” me Nr. 12-320/04-18934 e datës 23.06.2026 **është e pabazuar**, sepse:

- Kryetari i komisionit për ankesa, Avdirrahman Sadiku, me datën 30.06.2026 ka kërkuar nga anëtarët e komisionit vlerësues dokumentacionin, konkretisht aplikacionin e OJQ Shoqeria Kulturore-Artistike “SHKA-Jonuz Ramadani” me Nr. 12-320/04-18934 e datës 23.06.2026.
- Komisioni për shqyrtimin e ankesave, gjatë shqyrtimit të ankesave, konkretisht ankesës e OJQ Shoqeria Kulturore-Artistike “SHKA-Jonuz Ramadani” me Nr. 12-320/04-18934 e datës 23.06.2026 konstaton që, komisioni vlerësues për ndarjen e subvencioneve të drejtorisë ka qenë i themeluar konform Rregullores MF – Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

- Komisioni vlerësues ka respektuar nenin 4 të Rregullores MF – Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, konkretisht parimet e përgjithshme, duke respektuar konkurrueshmërinë, trajtimin e barabartë dhe mos diskriminimin e aplikuesve, transparenca në procedura e parimet e tjera konform nenit të cekur më lartë.
- Komisioni i ankesave konsideron dhe vlerëson se komisioni për ndarjen e subvencioneve, duke vlerësuar e analizuar aplikacionin e Shoqëria Kulturore-Artistike “Jonuz Ramadani” me Nr. 12-320/04-18934 e datës 23.06.2026 sipas projektit (“50 Kultur, 50 vjet Art” formulari 10 dhe Deklarata mbi financimin e projektit “Artistet për diasporën”, pra ka dallim në aplikacion dhe formular), ka vendosur drejt, sipas thirrjes publike, buxhetit të Drejtorisë së DKRS-ë për vitin 2026 (duke pasur parasysh dallimin e buxhetit nga viti paraprak), në përputhje me procedurat sipas Rregullores 04/2017 dhe është në diskrecionin e komisionit vlerësues mbështetja financiare bazuar në aplikacionin dhe aktivitetet e parapara të OJQ Shoqëria Kulturore-Artistike “SHKA-Jonuz Ramadani” me Nr. 12-320/04-18934 e datës 23.06.2026.

Andaj, mbi bazën e të gjeturave dhe konstatimeve si më lartë, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, në përputhje me Ligjin mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 dhe Rregullores MF-04/2017, duke pasur parasysh interesin publik dhe ofrimin e mbështetjes për OJQ-të të cilat kontribuojnë në jetën e përditshme kulturore, sportive etj, dhe me qëllim të respektimit të ligjshmërisë, financimin përmes fondeve publike të projekteve dhe programeve që janë me prioritet, dhe në mënyrë të drejtë dhe transparente, të barabartë me kriteret e qarta, duke respektuar dyshkallëshmërinë, parimet e llogaridhënies dhe ruajtjen e pavarësisë së përfituesve, ka ardhë në përfundim dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Vendimi i komisionit të ankesave është vendim përfundimtar në procedurën administrative, andaj palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në afat prej 30 dite nga data e njoftimit në web faqen e komunës, pran Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative.

Vendimi ju dërzohet:

1. OJQ-së ankuese - SHKA-Jonuz Ramadani, e përfaqësuar nga z.Muhamet Maliqi;
2. Komisionit vlerësues;
3. Komisionit të ankesave;
4. Arhivës komunale;

Viti, më 01.07.2026

Avdirrahman Sadiku, kryesues i komisionit

Arian Alidema, anëtar

Bashkim Sadiku, anëtar

